



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 03.04.2025
Numër Protokolli: 2227/2025

A.nr.416/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.416/2025, të datës 04.03.2025, të parashtruar nga ankuesja XH.P, kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedist, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.416/2025, të datës 04.03.2025, të parashtruar nga ankuesja XH.P.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile XH.P (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesja), më datë 04.03.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos njohjen përvojës së punës për vitet 1990-1999.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 12.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMMPHI), ndërsa, kjo e fundit, më datë 19.03.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë, se bashku me provat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.416/2025, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja sipas Akt-it të emërimit 01.01.2015, mbanë pozitën e punës Teknike e Hidrologjisë, në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës-Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës/MMPHI.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore e MMPHI, më Vendim me numër protokolli 5217/224, të datës 13.08.2024m ankueses i ka njohur pervojën e punës për periudhën nga 16 janar 1981 deri më datë 08 gusht 1990, ndërsa, për njohjen e pervojë së punës për periudhën viti 1990 deri 1999, do të zbatohet me rastin e nxjerrjes së aktit nënligjor.

Ankuesja në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se pervoja e punës për vitet 1990-1999 nuk është duke ju njohur siç ju ka njohur disa zyrtarëve në kuadër të institucioneve. Kërkon që të trajtohet ankesa si e bazuar dhe ti njihet pervoja e punës për vitet 1990-1999.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e ankesës së ankueses, konstaton faktin se MMPHI, me rastin e përgjigjes në ankesë të datë 19.03.2025, si provë materiale ka dërguar Vërtetimin me numër protokolli 416-2/25 të datës 18.03.2025, të nxjerr nga Divizioni i Burimeve Njerëzore ku përveç faktit se ankuesja sipas listës së pagave ka 33 vite e 9 muaj pervojë pune, të njëjtës i është njohur edhe pervoja e punës nga data 09.08.1990 deri më datë 31.12.1999, dhe atë 9 vite e 4 muaj pervojë pune, rrjedhimisht sipas vërtetimi rezulton se ankueses i janë njohur gjithsej 43 vite e 1 muaj pervojë pune. Po ashtu sipas përgjigjes në ankesë të datës 19.03.2025 është dhënë sqarimit se: *Meqenëse deri më tani nuk ka akt nënligjor siç është përcaktuar edhe me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, bazohemi në vendimin me numër 2292/2023 të datës 19.10.2023 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për të mos vazhduar me diskriminim ndaj të drejtës së fituar dhe në muajin prill do të dërgohet në pejroll për procedim të këtij vërtetimi.*

Andaj, në frymën e fakteve si më lartë, rrjedhimisht duke qenë së Vërtetimin me numër protokolli 416-2/25 të datës 18.03.2025, të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore ankueses i është njohur pervoja e punës për periudhën kontestuese gjegjesisht për vitet 1990 deri 1999, atëherë, Kolegji erdhi në përfundimin së objekti i ankesës A.nr.416/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*. Rrjedhimisht, objekti –qëllimi për të cilin pala ka bërë ankesë në Këshill tashmë është realizuar nga organi i punësimit, kështu që, në këtë rast nuk ka edhe objekt kontesti.

Përbledhur si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi, ashtu që përfundon procedimin administrativ i incuar sipas ankesës më numër A.nr.416/2025, të datës 04.03.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.416/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses XH.P;*
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*